



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 17 prill 2020  
Kodi i ZRRE: V\_1250\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duku u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Neni 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Parimet për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (SHST) dhe taksave të kyçje;
- Vendimin V\_1238\_2020 të datës 6 prill 2020 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për OST/OT;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST);
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Tregut; dhe
- Kërkesën/aplikacionin e KOSTT SH.A për miratimin e tarifave të OST/OT në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, të dorëzuar më datën 8 prill 2020,

në seancën e mbajtur më 17 prill 2020 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut (KOSTT SH.A), për periudhën 1 prill 2020 - 31 mars 2021.
- II. Struktura e tarifave për KOSTT SH.A, e cila do të zbatohet nga data 1 prill 2020 është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org



Nr. 147/20  
Data 22.04.2020

Grupi tarifor	Elementi tarifor	Njësia	Tarifa
Prodhimi i kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.014
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.029
Prodhimi i kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.190
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.029
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.856
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.025
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	7.543
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	15.530
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.856
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.025
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	3.802

## ARSYETIM

- ✚ ZRRE më datë 8 prill 2020 ka pranuar nga KOSTT SH.A, kërkesën/aplikacionin për tarifat e OST/OT.
- ✚ ZRRE me rastin e vendosjes së tarifave për OST/OT, ka marrë parasysht dokumentet e përgatitura, lëshuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së si në vijim:

- Raport Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT (prill 2020 - mars 2021), i publikuar më 19 shkurt 2020; dhe
- Raport përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së, Përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2020 - mars 2021), i publikuar më 27 mars 2020.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, i cili do të zbatohet nga KOSTT SH.A, duke filluar nga data 1 prill 2020 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**



Arsim Janova, u.d kryesues



Besim Selçijaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Bushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.